



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2021
Nr. Dok. 202101120/2

Lënda : Rekomandime mbi inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Dibër.

Drejtuar: Drejtues i parë Skënder HITAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër

PESHKOPI

Kryekomisar Pal MARKU
Shef i Komisarimit të Policisë Dibër

PESHKOPI

Për dijëni: Drejtues Madhor Gledis NANO
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, neni 81 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Dibër.

Inspektimi u krye në datën 30.07.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj.Ermonela Xhafa, Komisionere e MKPT-së, si dhe z.Besnik Deda, znj.Gloria Çarkaxhiu, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen personat e privuar nga liria, grupi i punës u takua me Drejtorin e DVP Dibër z.Artur Selimi dhe Shefin e Komisarariatit të Policisë Dibër z.Pal Marku, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen dhe kushtet në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe sigurisë të komisarariatit, trajtimin që ju bëhet personave të privuar nga liria në këto mjedise, standardet që zbatohen nga punonjësit e policisë për respektimin e të drejtave të këtyre personave, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës monitoruese, inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e punonjësve të policisë të cilët kryejnë veprime proceduriale me shtetasit e shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin ku pasqyroheshin veprimet e kryera me këta persona.

Vlerësojmë se, drejtuesit e Drejtorisë dhe të Komisarariatit të Policisë Dibër, si dhe punonjësit e policisë, u treguan bashkëpunues dhe transparentë me grupin e monitorimit të MKPT-së, gjatë vizitës inspektuese në ambientet e këtij Komisaritati.

Gjatë inspektimit, ju kushtua një vëmendje e veçantë edhe zbatimit të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19, në mjediset e komisarariatit. U evidentua se, punonjësit e policisë ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe ruanin distancën fizike me njëri tjetrin. Në vende të aksesueshme (korridore) ishin vendosur dezinfektant për pastrimin e duarve. Gjithashtu, masat mbrojtëse ndaj COVID-19 zbatoheshin dhe nga personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë dhe ato të shoqërimit, si dhe nga punonjësit e policisë në zyrat e tyre të punës.

Furnizimi me maska mbrojtëse dhe dezinfektantët për duart kryhej periodikisht çdo 3 muaj nga DVP Dibër, por një pjesë e tyre ishin siguruar nga donacione të ofruara nga subjekte private. Ambientet e zyrave të punës, automjetet e patrullimit, si dhe dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin dezinfektuar periodikisht nga një subjekt privat i kontraktuar nga drejtoria e policisë, sipas një grafiku të miratuar çdo 15 ditë.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, në përfundim të inspektimit të zhvilluar në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, u konstatua se nuk ishte zbatuar rekomandimi për **mbylljen e dhomave të sigurisë**, pasi gjendja teknike e godinës të komisarariatit ishte shumë e amortizuar dhe mungonin kushtet e jetesës për personat e arrestuar/ndaluar që mbahen dhe trajtohen në këto mjedise.

Grupi i inspektimit konstatoi se, dhomat e sigurisë ishin ende funksionale, megjithëse gjendja teknike e godinës dhe kushtet e ambientit ku ndodhen dhomat e shoqërimit dhe të

sigurisë vazhdonin të ishte e njëjtë. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, situata në të cilën ndodhen dhomat e sigurisë dhe të shoqërimit, krahasuar me standardet që duhet të plotësojnë këto ambiente në bazë të akteve ligjore dhe atyre ndërkombëtare, përbën një trajtim jo dinjitoz të shtetasve që qëndrojnë në këto mjedise, sipas cilësisë të ndaluar/arrestuarve deri edhe 96 orë për vleftësimin e masës të sigurisë nga ana e gjykatës, sipas afatit të përcaktuar në nenet 258/1 dhe 259/5, të Kodit të Procedurës Penale.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr.1799/1 prot., datë 06.04.2020, në përgjigje të rekomandimit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit, informon se është e pamundur “mbyllja dhe mos përdorimi i ambientit të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Dibër, për shkak të mungesës të ambienteve të tjera për mbajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar”.

Në vijim të kësaj shkrese me përgjigje, na bëhet gjithashtu me dije se, është hartuar dhe miratuar projekti për rikonstruksionin/ndërtimin e të gjitha ambienteve/godinave ekzistuese të DVP-së dhe Komisarlatit të Policisë Dibër, ku midis të tjerave janë parashikuar dhe ndërtimi i ambienteve të reja të sigurisë dhe të shoqërimit të personave në këto mjedise. Financimi i këtij projekti ishte parashikuar për vitin 2020, por për shkak të pamjaftueshmërisë së buxhetit, është shtyrë për vitin 2021.

Grupi i inspektimit, në takimin me drejtuesit e DVP-së dhe Komisarlatit të Policisë Dibër, u informua se ky projekt do të fillojë të zbatohet për vitin 2021, referuar shkresës të vënë në dispozicion me nr.1880 prot., datë 03.06.2021 të DPPSH-së, në të cilën njoftohen për planifikimin e këtij investimi në buxhetin e vitit 2021 dhe masat që duhet të merren nga organet e policisë në Dibër, për implementimin e projektit “*Rikonstruksioni/ndërtimi objekteve të drejtorisë dhe Komisarlatit të Policisë Dibër*”. Vlera e projektit do të jetë 303.5 milionë lekë (të reja) dhe me financim nga buxheti i shtetit. Aplikimi për lejen e ndërtimit është bërë në sistem në datë 18.11.2020 dhe aktualisht, sipas informacionit, është në proces shqyrtimi. Menjëherë pas miratimit të lejes së ndërtimit, do të fillojë zbatimi i projektit dhe punimet për ndërtimin e godinave do të zgjasin 24 muaj.

Grupi i inspektimit evidentoi gjithashtu se, në gjendjen që ndodhen dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, Drejtoria dhe Komisarlati i Policisë Dibër, megjithëse punonin në kushte të vështira, kishin marrë disa masa për të përmirësuar kushtet e jetesës për personat që qëndrojnë në këto ambiente, për të cilat duhen inkurajuar. Më konkretisht:

1. Ishte krijuar ambient i veçantë hetimi, **për marrjen në pyetje dhe intervistimin e të miturve**, me kushte të përshtatshme për trajtimin dinjitoz të të miturve, i plotësuar me orenditë e nevojshme për mbajtjen dhe qëndrimin e tyre, si dhe i monitoruar nga sistemi i kamerave;
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për **trajnimin e stafit të policisë** që në procesverbalin e arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të personave, punonjësit e policisë të vendosnin orën kur ata janë shoqëruar për në mjediset e policisë dhe jo orën kur ata hyjnë në dhomat e sigurisë.
3. Ishte zbatuar rekomandimi **për dizifektimin e dhomave të sigurisë kundër brejtësve** dhe largimin e erërave të këqia që e ndotin ambientin;
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për **sigurimin në dhomat e sigurisë të pajisjeve elektrike** që shërbejnë për ngrohje në periudhën e dimrit.

Gjithashtu, u evidentua se **nuk** ishin zbatuar rekomandimet në lidhje me:

1. Pajisjen e dhomave të sigurisë me shtretër për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit fizik të dhomave të sigurisë;
2. Nuk ishte bërë zëvendësimi i materialeve të fjetjes të vjetëruara dhe të dëmtuara si dyshekë, batanie e jastëk, me materiale të reja;
3. Nuk ishte bërë zgjerimi i dritareve të dhomave të sigurisë, pasi ato nuk lejonin ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral të këtij ambienti;
4. Nuk ishte kryer asnjë investim për izolimin e brendshëm dhe të jashtëm të godinës ku ndodhen dhomat e sigurisë, me qëllim reduktimin e lagështirës brenda këtyre ambienteve.
5. Nuk ishin instaluar sistemi i kamerave për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të dhomave të sigurisë.
6. Ambienti i shoqërimit nuk ishte i plotësuar me 3(tre) dhoma të ndara më vete për të shoqëruarit në moshë madhore, femrat dhe të miturit;
7. Nuk ishte krijuar dhomë (zyrë) më vete për marrjen në pyetje/intervistimin nga oficerët e policisë gjyqësore të personave të shoqëruar, para se ata të kalojnë në ambientin e sigurisë dhe instalimin brenda saj të sistemit të monitorimit me kamera.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatit e Policisë Dibër, ambienti i shoqërimit **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre, ndërkohë në aktet e lartpërmendura në lidhje me kushtet e mbajtjes dhe sigurinë e personave të shoqëruar, theksohet se: “*Mjedisi/ambienti duhet të jetë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim.....si dhe dhoma të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit*”.¹

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës së këtij komisariati dhe kishte vetëm 1(një) dhomë shoqërimi, e cila përdorej për shoqërimin e shtetasve të rritur. Dhoma e shoqërimit ishte me përmasa 6x5m dhe mbyllej me derë druri, ndërsa përmasat e dritares ishin të tilla që lejonin ajrim dhe ndriçim natyral. Ndërkohë, ndriçimi artificial sigurohej nga rrjeti elektrik. Dhoma e shoqërimit ishte e lyster dhe e pastër nga ana higjieno-sanitare. Gjithashtu, ajo ishte e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Kapaciteti ishte për qëndrimin ulur deri 7(shtatë) persona të shoqëruar.

Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndërkohë nga regjistri i të shoqëruarve, për periudhën Janar – Korrik 2021 rezultoi se ishin shoqëruar për në mjediset e komisariatit 151 persona.

Për mbajtjen dhe qëndrimin e personave të shoqëruar femra dhe të mitur, përdorej një zyrë e cila ndodhej në katin e dytë të godinës së komisariatit dhe shërbente njëkohësisht dhe si zyrë pune për punonjësit e policisë. Asnjë prej dhomave të shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje. Në koridorin e godinës, afër dhomës së shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, por dhe ajo ishte jashtë funksionit.

¹ Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Në ambientin e shoqërimit, **nuk** ishte i instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, me qëllim kontrollin e veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me të shoqëruarit.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve, vazhdonte të kryhej në zyrat e punonjësve të policisë, në mungesë të një dhome të veçantë që të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive, e cila do të parandalonte kryerjen e veprimeve të kundraligjshme me të shoqëruarit si dhe çdo kundërveprimi të këtyre personave ndaj punonjësve të policisë.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në korridorin ku ndodhet ambienti i shoqërimit ishin afishuar posterat me të drejtat që gëzojnë personat e shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit. Në mungesë të intervistave me personat e shoqëruar, nga informacioni i punonjësve të policisë të komisariatit, grupi i inspektimit evidentoi se personave të shoqëruar ju jepej karta e të drejtave që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Gjatë inspektimit, në ambientin dhe dhomat e shoqërimit, nuk u konstatuan sende dhe mjete të tilla që mund të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Gjithashtu, u evidentua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109 paragrafi 5² dhe 122 paragrafi 5³ e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4⁴ të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse, i cili në përfundim të procedurave, një kopje të firmosur ja jepte personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë Dibër, **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në procedurën standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 dhe në kushtet në të cilën ndodhet ky ambient, ato bien në kundërshtim të hapur me standardet e përcaktuara në “*Konventa europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese*”⁵.

² Neni 129 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar parashikon se: “*Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.*”

³ Neni 122 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar parashikon se: “*Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.*”

⁴Urdhër, nr. 938 datë 24.07.2019 “Procedura standarde e punës për: “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*” a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “*Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.*”

⁵ <https://rm.coe.int/16806dbac6>

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të godinës të komisariatit, ku ndodheshin 13 dhoma sigurie, nga të cilat ishin funksionale vetëm 4(katër) dhoma për personat e arrestuar/ndaluar. Ndërsa, 9(nëntë) dhomat e tjera ishin të mbyllura dhe të vulosura, pasi ato ishin jashtë kushteve teknike dhe kriterëve për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar.

Dhomat e sigurisë ishin të ndara në 2 dhoma për personat e arrestuar/ndaluar të rritur, 1 dhomë për femrat dhe 1 dhomë për të mitur. Kapaciteti fizik ishte për mbajtjen dhe sigurimin e 6 personave të arrestuar/ndaluar. Përmasat e dhomave ishin 3x2m dhe nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, të hapësirës dhe sipërfaqes për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra², dhe nuk ishte e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁶

Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe **nuk** mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ndërsa ndriçimi artificial sigurohej nga rrjeti elektrik dhe një gjenerator për rastet kur kishte ndërprerje të energjisë elektrike.

Dhomat e sigurisë **nuk** ishin të plotësuara me krevatë për fjetjen e personave të ndaluar/arrestuar, ndaj në këto kushte këta persona flinin me dyshekë që vendoseshin në dyshemënë prej dërrase. Dhomat ishin të pajisura me materialet e fjetjes si dyshekë e batanije, por ato ishin të vjetëruara dhe të dëmtuara.

Në ambientin e sigurisë, lagështira vazhdonte të ishte prezente kudo dhe muret e brendshme të dhomave ishin të amortizuara. Në rastet kur binte shi, tavani i dhomave pikonte dhe kishte krijuar shenja myku në mure, duke e bërë të pamundur qëndrimin dhe trajtimin dinjitoz të personave të arrestuar/ndaluar, që sigurohen në këto dhoma.

Në korridorit e ambientit të sigurisë, ndodhej një ambient i përbashkët që shërbente si tualet dhe për larjen e trupit. Ambienti ishte i plotësuar me nyje hidrosanitare, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë).

Ambienti i sigurisë **nuk** kishte të instaluar sistemin ngrohje/ftohje me kaldajë qëndrore, sikurse parashikohet në pikën 3/c, Kreu VIII të procedurës standarde. Për shkak të kushteve të rënduara atmosferike në periudhën e dimrit në këtë zonë, ngrohja sigurohej me pajisje elektrike të siguruara nga vetë institucioni, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë **nuk** kishte aparat telefonik fiks apo citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Po ashtu, në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile për njoftimin e personelit të shërbimit, në rastet e nevojave nga personat e ndaluar/arrestuar.

Në ambientin e sigurisë kishte një dhomë të përbashkët që përdorej si zyrë pune nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, por edhe si dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët mbrojtës dhe marrjen e tyre në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur, por **nuk** ishte e

⁶ Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".

monitoruar me sistemin e kamerave. Nisur nga funksioni që kanë këto ambiente, ato duhet të jenë të ndara secila dhomë më vehte she të jenë të monitoruara me kamera.

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, por dhe kjo **nuk** përmbushte standardet pasi ishte e pandriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Për marrjen në pyetje të të miturve, ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, në kuadër të projektit 2019-2021 të financuar nga DPPSH, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe UNICEF për ndërtimin e këtyre ambienteve në disa nga drejtoritë/komisariatet e policisë së shtetit. Ky ambient përbëhej nga 3 dhoma të pajisura me mjetet dhe orëditë e punës për specialistët e policisë të trajnuar për këtë qëllim, për psikologun, si dhe për qëndrimin ulur dhe komod të fëmijës dhe të prindit (kujdestarit ligjor), sikurse përcaktohet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit dhe në procedurën standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar.

Ambienti i sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë nuk monitoroheshin gjithashtu nga sistemi i kamerave.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë nuk ndodhej asnjë person i ndaluar/arrestuar. Për periudhën e inspektimit Janar – Korrik 2021 në dhomat e sigurisë të këtij komisarati, janë trajtuar dhe siguruar 67 persona të arrestuar/ndaluar dhe asnjë prej tyre nuk ishte femër dhe i mitur. Sipas shënimeve në regjistër, nuk rezultoi të kishte mbipopullime në dhomat e sigurisë, në asnjë periudhë kohore.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarimit dhe punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë, personat e ndaluar/arrestuar trajtoheshin me ushqim 3(tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr.189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi gatuhej në mención që ndodhej brenda territorit të komisarimit dhe shërbehej sipas vakteve nga kuzhinerët dhe punonjësit e policisë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i përgjegjësit të dhomave të sigurisë, personave të ndaluar/arrestuar u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës inspektuese nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisaratin e Policisë Dibër “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019. Regjistri ishte i plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë, në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarariat evidentoheshin në “*Regjistrin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar*”, i cili ishte i sekretuar. Edhe ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë të komisarariatit.

Nga këqyrja e këtyre regjistrave rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë. Kjo situatë, u verifikua edhe për personat e ndaluar apo të arrestuar nga Komisarati i Policisë së Bulqizës (Komisarati i Policisë Burrel ka dhoma sigurie), të cilët në përfundim të procedurave ligjore të kryera nga specialistët e krimeve, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër.

Avokati i Popullit, ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e futjes në mbikqyrje policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe nenin 109, pika 4 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Nga inspektimi u evidentua se, komisarati **nuk** kishte regjistër të veçantë për të miturit të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar në konflikt me ligjin, ku të evidentohen të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në dhomat e sigurisë të komisarariatit kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në Komisaratin e Policisë Dibër, u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin mbrojtës dhe prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, si dhe regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes.

Gjithashtu, në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe zyrën e informacionit, ndodhej karta me të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe e përkthyer në 8 gjuhë të huaja, të cilat u jepeshin personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes mjediset e komisarariatit, pra në kohën kur presupozohet se këtyre shtetasve ju privohet liria.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Dibër, punonjësit e policisë gjyqësore i kryenin intervistat dhe marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës të ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë, dhoma për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, shërbente zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, pra nuk ishte një ambient më vehte. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparëshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar⁷.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Grupi i inspektimi, konstatoi dhe një problematikë që kishte të bënte me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të procesit të marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të policisë së shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018- të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë⁸. Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisarlatit.

Grupi i inspektimit, evidentoi si një praktikë të mirë në Komisarlatin e Policisë Dibër, investimin e realizuar me fondet e Qeverisë të Mbretërisë të Bashkuar dhe UNICEF, për krijimin e 3 dhomave të përshtatura për intervistimin ashtu dhe për qëndrimin e të miturve të arrestuar/ndaluar apo të dënuar. Ato ishin të pajisura me të gjitha orëditë e nevojshme si tavolina, kolltuqe, bibliotekë për libra, postera informues, si dhe ishte e monitoruar me sistemin audio-viziv.

⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

⁸ Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28⁸.

Në këto ambiente kryhej procedura e marrjes në pyetje të të miturve nga punonjësit e policisë, në prezencë të kujdestarit ligjor(familjarit), avokatit mbrojtës dhe psikologut. Pamjet filmike të kamerave që monitorojnë ambientin ku merren në pyetje të miturit, ruhen deri në 30 ditë në një server që administrohej nga DVP Dibër.

Nga monitorimi në kohën e inspektimit i zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore në këtë komisariat, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në ambientet e godinës të komisariatit, ishte krijuar një ambient i veçantë (magazine) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, në interes të hetimit që zhvillonte organi i prokurorisë.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Sikurse u përmend edhe më lart, në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër, nuk kishte asnjë person të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit u informua nga punonjësit e policisë se personat e arrestuar/ndaluar, trajtohen në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimin në ambientin e sigurisë. Gjithashtu, personat që hyjnë në mjediset e policisë, në cilësinë e të shoqëruarit apo të ndaluar/arrestuar, vihen në dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin marrin kontakt dhe informohen për kryerjen e veprimeve procedurale.

Në Komisariatin e Policisë Dibër zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 109 paragrafi 5 dhe 122 paragrafi 5 e ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e kopjes të procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse, pas firmosjes nga ana e tyre. Kjo u evidentua nga kopjet e proces verbaleve që ndodheshin në zyrën e informacionit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Gjithashtu, në Kodin e Procedurave Penale, neni 34/b, pika 2 dhe 251, parashikohet se dhe personave të ndaluar/arrestuar duhet t’i jepet dhe të mbajnë me vehte një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan nga grupi i inspektimit në fashikujt që administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Sipas informacionit, u evidentua se zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, atyre ju ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, dhe mundësinë për të kontaktuar me të.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë. Për shtetasit e ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndalurave/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe në raste të veçanta asistoheshin dhe nga psikologët që siguroheshin nga Bashkia Dibër dhe Shkolla e Mesme e qytetit Peshkopi.

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizitat mjekësore në mungesë të mjekut në organikë të DVP Dibër, kryheshin nga mjekët e Spitalit Rajonal Dibër brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”⁹.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu, për secilin person hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjithsesi, mungesa e mjekut apo ndihmësmjekut me kohë të plotë në bazë të strukturës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, çënon standardin për trajtim mjekësor me dinjitet të personave të arrestuar/ndaluar, për kohën që qëndrojnë në dhomat e sigurisë të Drejtorisë/komisariateve në varësi të saj.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridoret e godinës të këtij komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, por ato duhen të vendosen dhe brenda në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe në vende që të jenë të aksesueshme nga të ndaluarit dhe të shoqëruarit në mjediset e policisë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues*”:

REKOMANDOJMË:

- Deri në përfundimin e zbatimit të projektit për “Rikonstruksionin e ambienteve të Drejtorisë Verilidore të Policisë Dibër”, me qëllim garantimin e standardeve minimale të kushteve të jetesës në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër, të marren masa të menjëhershme dhe konkretisht:***

⁹ *Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

- a. Plotësimi i menjëhershëm i dhomave të sigurisë me shtretër për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit fizik të dhomave;
 - b. Të bëhet zëvendësimi i menjëhershëm i materialeve të fjetjes të vjetëruara si dyshekë, batanie, jastëk, me materiale të reja;
 - c. Kryerja e rikonstruksioneve të pjesëshme të mureve të brendëshme, lyrjen me bojë dhe dizifektimin e dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë;
 - d. Zgjerimin e përmasave të dritareve të dhomave të sigurisë, sipas parametrave teknik dhe të sigurisë, pasi ato janë shumë të vogla dhe nuk lejojnë ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral;
2. Trajnimin e stafit të policisë, për njohjen me rekomandimet e KPT(CPT)-së në lidhje me informimin dhe pajisjen me kartën e të drejtave që gëzojnë personat e shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar, që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit në mjediset e policisë), me qëllim për të garantuar zbatimin korrekt dhe në mënyrë efektive të të drejtave të këtyre personave.
 3. Vendosjen e posterva me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar brenda dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë.
 4. Instalimin e sistemit të kamerave për mbajtjen në vëzhgim të korridorit, dhomave të sigurisë dhe dhomës të shoqërimit;
 5. Plotësimin e organikës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmësmjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjeksore të personave të ndaluar/arrestuar;
 6. Krijimin e menjëhershëm të një regjistri të veçantë për evidentimin e të dhënave të të miturve të shoqëruar në mjediset e komisariatit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA